

Vendim nr. 190, datë 08.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 08.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (V) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VASFI KAMBERI**, përfaqësuar nga avokati Bari Shyti, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1679 (86-2024-1805), datë 08.10.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-4068, datë 18.11.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 41, 42, 131, 134 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, me shkresën nr. 1045/4 prot., datë 16.05.2006, dalë në zbatim të urdhrin nr. 867, datë 11.05.2006 të ministrit të Brendshëm, është punësuar efektiv në strukturat e Ministrisë së Brendshme, ku është rititulluar “Oficer aktiv” dhe është emëruar në Gardën e Republikës (*Garda*), me gradën “Major”, me fillim efektesh administrative dhe financiare, datë 12.05.2006. Me urdhrin nr. 271, datë 29.05.2013 të ministrit të Brendshëm “Për zhvillimin e procesit të konkurrimit për gradë e karrierë dhe për funksionimin e komisioneve të gradave e të karrierës për vitin 2013 në Gardën e Republikës”, është miratuar që gjatë muajit qershor 2013 të zhvillohej procesi i konkurrimit për gradë e karrierë për efektivët oficerë dhe nënoficerë të Gardës. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për të qenë pjesë e konkurrimit dhe sektori i burimeve njerëzore në muajin qershor 2013 i është drejtuar me memo komandantit të Gardës dhe për shqyrtim komisionit të gradave dhe karrierës, duke propozuar për kërkuesin që për mosplotësim të kërkesave të nenit 15, pika 1, shkronja “b” (arsimimi dhe kualifikimi) të ligjit nr. 9366, datë 31.03.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr.9366/2005*), të mos trajtohet me gradën e radhës. Komandanti i Gardës ka hedhur poshtë propozimin, duke kërkuar të përgatitet praktika për gradën e radhës për kërkuesin.

2. Me shkresën nr. 1636 prot., datë 16.07.2013, me lëndë: “Propozim për dhënie grade një oficeri në Gardën e Republikës”, drejtuar Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, është propozuar që kërkuesit t’i jepet grada “Nënkolonel”, bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 9366/2005. Me urdhrin nr. 325, datë 18.07.2013 të ministrit të Brendshëm “Për dhënie grade një oficeri”, pas kërkesës së kërkuesit dhe shkresës nr. 1636, datë 16.7.2013 të komandantit të Gardës, ai ka marrë gradën “Nënkolonel”, si gradim i parakohshëm. Në urdhrin e sipërcituar, justifikohet dhënia e gradës me argumentin se: *“Major Vasfi Baftjar Kamberi, me detyrë në funksionin organik nivel i lartë në strukturë, me përputhshmëri niveli grade me gradën Major, për punë me disiplinë të lartë, profesionalizëm e përkushtim, për realizimin e të gjithë detyrave dhe objektivave, si dhe në kuadër të 24-qershorit, 85-vjetorit të ditës së krijimit të Gardës së Republikës, t’i jepet gradim i parakohshëm N/kolonel dhe të jetë në dispozicion për emërim në funksion organik të nivelit me përputhshmëri niveli grade Major-N/kolonel...”*.

3. Pas katër muajve nga urdhri për dhënie grade, mbi propozimin me nr. 2797 prot., datë 02.10.2013 të komandantit të Gardës, ka dalë urdhri nr. 325/1, datë 05.11.2013 i ministrit të Brendshëm, me të cilin kërkuesit i është hequr grada “Nënkolonel”, si e marrë jashtë kriterëve të përcaktuara në ligj, duke anuluar (revokuar) urdhrin nr. 325, datë 18.07.2013 të ministrit të Brendshëm për dhënien e gradës “Nënkolonel”, si dhe duke i ridhënë atij gradën “Major” që kishte mbajtur më parë. Në relacionin shoqërues për nxjerrjen e urdhrin, mbajtur prej komandantit të Gardës, është verifikuar se grada e dhënë me urdhrin nr. 325, datë

18.07.2013 të ministrit të Brendshëm është në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 9366/2005. Me shkresën nr. 1636/4 prot., datë 08.11.2013, në zbatim të urdhrit të sipërcituar nr. 325/1, datë 05.11.2013 të ministrit të Brendshëm, komandanti i Gardës ka vendosur që të behej ndryshimi për trajtimin financiar të pagës bazë me pagën për gradën “Major” për kërkuesin, ndryshim i cili ka filluar efektet në datën 05.11.2013. Ky urdhër është ankimuar nga kërkuesi te ministri i Brendshëm, me ankesën e datës 11.11.2013, për të cilën nuk ka marrë përgjigje. Në vijim, me aktin propozues nr. 2548 prot., datë 2.11.2015, komandanti i Gardës i ka propozuar ministrit të Brendshëm që kërkuesi të nxirrej në rezervë dhe të trajtohej financiarisht me pagesë kalimtare. Me urdhrin nr. 615, datë 01.12.2015 të ministrit të Brendshëm, është vendosur lirimi para kohe nga detyra dhe nxjerrja në rezervë e kërkuesit, me arsyetimin se ka plotësuar kohën maksimale të qëndrimit në gradën “Major”, në pamundësi konkurrimi për gradën e radhës. Kjo procedurë është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nga kërkuesi dhe kjo e fundit, me vendim të formës së prerë, ka vendosur rregullimin e pasojave, pasi akti u konsiderua relativisht i pavlefshëm dhe kërkuesi ishte rikthyer në detyrë në Gardë me gradën “Nënkolonel” në vitin 2020.

4. Kërkuesi gjithashtu pas më shumë se dy vjetësh, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë, me palë të paditur Ministrinë e Brendshme dhe Gardën, duke kërkuar shpalljen absolutisht të pavlefshëm të urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 325/1, datë 05.11.2013 “Për anulimin (revokimin) e urdhrit nr. 325, datë 18.07.2013 “Për dhënie grade “Nënkolonel” oficerit Vasfi Kamberi””, si dhe llogaritjen e pagës dhe pagesën e saj në favor të tij, duke filluar nga data 01.07.2013 e në vijim, në bazë të gradës “Nënkolonel”.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 595, datë 21.02.2020, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesi dhe konstatimin absolutisht të pavlefshëm të urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 325/1, datë 05.11.2013, si dhe detyrimin e palëve të paditura për përlllogaritjen e pagës dhe pagesën e saj në favor të tij, duke filluar nga data 01.07.2013 e në vijim, në bazë të gradës “Nënkolonel”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Garda.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1679 (86-2024-1805), datë 08.10.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 595, datë 21.02.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4068, datë 18.11.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se rekursi nuk i përmbushte kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Në datën 13.03.2026 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të:*

8.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi ankimi për pavlefshmërinë absolute të aktit është bërë nga Garda, ndërkohë që ky pretendim i takonte ekskluzivisht Ministrisë së Brendshme, e cila e kishte nxjerrë aktin. Në këto kushte, pavarësisht se Garda përfaqësonte me autorizim edhe ministrinë, gjykata e apelit nuk duhej ta kishte marrë parasysh këtë prapësim tej kufijve të ankimit. Edhe Gjykata e Lartë nuk e ka ndrequr këtë të metë, duke e konsideruar të drejtë arsyetimin e gjykatës së apelit.

8.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi gjykata e apelit mbi interpretimin logjik të dispozitës i jep asaj një tjetër kuptim nga sa është sanksionuar në tekst, duke kaluar në një interpretim arbitrar të saj. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, megjithëse është gjendur përpara dy vendimeve diametralisht të kundërta është mjaftuar të shprehet me arsyetim të kufizuar, ndërkohë që pretendimi i tij kishte lidhje pikërisht me zbatimin e gabuar të ligjit material. Për më tepër, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike lidhur me të drejtën e tij për të mos jetuar me frikën se marrëdhënia e krijuar mund të ndryshojë në çdo moment, duke sjellë pasoja negative.

8.2. *E drejta e pronës*, pasi akti administrativ i dhënies së gradës “Nënkolonel”, i cili është revokuar, prodhon të drejta pasurore për kërkuesin. Gjykata Administrative e apelit dhe Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimeve të tyre e kanë cenuar këtë të drejtë të tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Për sa u takon kriterëve kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

11. Kolegji konstaton, fillimisht, se kërkuuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ankimi për pavlefshmërinë absolute të aktit është bërë nga Garda, ndërkohë që ky pretendim i takonte ekskluzivisht Ministrisë së Brendshme që kishte nxjerrë aktin. Në këto kushte, pavarësisht se Garda përfaqëson me autorizim edhe ministrinë, gjykata e apelit nuk duhej ta kishte marrë parasysht këtë prapsim tej kufijve të ankimit. Edhe Gjykata e Lartë, sipas tij, nuk e ka ndrequr këtë të metë, duke e konsideruar të drejtë arsyetimin e gjykatës së apelit.

12. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin

procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vëren se ai nuk është ngritur nga kërkuesi në rekurs, duke mos shteruar në këtë mënyrë të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe, në këtë kontekst, ky argument i tij nuk mund të merret në shqyrtim. Për sa u takon pretendimeve të tjera të tij, ato janë ngritur në substancë në rekurs, ndaj vlerësohet se ai i ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke mos pasur mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese.

14. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës nga vendimmarrja e gjykatës së apelit dhe e Gjykatës së Lartë.

15. Nisur nga thelbi dhe përmbajtja e pretendimeve të kërkuesit, si dhe në konsideratë të faktit se neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë, ku përfshihet edhe e drejta e pronës, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Kolegji çmon që, në rastin konkret, këto pretendime të tij të analizohen në themel në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e aksesit, të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi gjykata e apelit për interpretimin logjik të dispozitës i jep asaj një tjetër kuptim nga sa është sanksionuar në tekst, duke kaluar në një interpretim arbitrar të saj. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, megjithëse është gjendur përpara dy vendimeve diametralisht të kundërta, është mjaftuar të shprehet me arsyetim të kufizuar, ndërkohë që pretendimi i tij kishte lidhje pikërisht me zbatimin e gabuar të ligjit material. Për më tepër, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike lidhur me të drejtën e tij për të mos jetuar me frikën se marrëdhënia e krijuar mund të ndryshojë në çdo moment, duke sjellë pasoja negative.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe se arsyetimi i kufizuar nuk

cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon standardit të arsytimit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit. Zbatimi i këtij standardi vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë, arsytimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se një arsyetim i tillë është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Mbi bazën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë argumentet e kërkuesit, Kolegji do të verifikojë nëse arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, ka përmbushur funksionin e një vendimi të drejtë nga pikëpamja e arsytimit të vendimit, si dhe nëse interpretimi i ligjit nga ato gjykata ka qenë ose jo arbitrar.

19. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar kërkesëpadinë e kërkuesit duke e konsideruar aktin revokues të ministrit të Brendshëm si një akt absolutisht të pavlefshëm. Gjykata Administrative e Apelit, për ankimin e Gardës, e ka ndryshuar atë vendim, duke arsyetuar se neni 124 i Kodit të Procedurave Administrative të Kohës (KPA), i cili bënte fjalë për të drejtën për të revokuar dhe shfuqizuar, në pikën 1 të tij parashikonte se me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, e drejta për të revokuar aktin i takon organit që e ka nxjerrë atë, ndërsa shfuqizimi i aktit është prerogativë e organit epror. Më tej, ajo arsyeton se neni 125 i KPA-së, mbi formën e aktit revokues, shprehej se me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, akti revokues ose shfuqizues ka të njëjtën formë ligjore dhe ndjek të njëjtat procedura me aktin që revokohet ose shfuqizohet. Në vlerësim të asaj gjykate, urdhri i ministrit është akt revokues, pasi e ka të përcaktuar shprehimisht në përmbajtjen e tij, dhe koncepti i revokimit të aktit është ai që i përgjigjej situatës konkrete, pasi ishte nxjerrë nga i njëjti organ që kishte nxjerrë edhe aktin që revokohej (pra nga ministri), në të njëjtën formë e mbi të njëjtën procedurë si akti që revokohet. Fakti që ligji specifik nr. 9366/2005 nuk kishte parashikuar shprehimisht të drejtën e ministrit për të revokuar aktet e nxjerra prej tij, nuk e privonte këtë të fundit nga referimi në KPA. Ajo gjykatë

për këtë pretendim ka çmuar se mungesa e parashikimit në *lex specialis* për të drejtën e organit publik për të revokuar aktin administrativ, nuk passillte pavlefshmëri absolute të aktit revokues, pasi mundësia për ta bërë këtë gjente parashikim në *lex generalis*, sikundër është KPA-ja.

20. Për sa i takon argumentit të përdorur nga shkalla e parë se revokimi është bërë në tejkalim të afatit 30-ditor të ankimit, ajo gjykatë e gjen të gabuar dhe vlerëson se pika 1 e nenit 123 të KPA-së, që parashikon së aktet administrative të pavlefshme mund të revokohen ose të shfuqizohen vetëm për shkak të pavlefshmërisë dhe brenda afatit kohor të caktuar për ankimin gjyqësor, në një interpretim logjik dhe literal të dispozitës synon të disiplinojë veprimtarinë e arsyetuar se, parashikimi i afatit kohor për të revokuar një akt lidhet me afatin për ankimin brenda parametrave kohorë që do t'i shërbenin subjektit që preket nga akti për t'iu drejtuar gjykatës. Sipas saj, logjika e këtij parashikimi është që pala e cenuar të mos i drejtohet gjykatës, në eventualitetin që vetë organi që ka nxjerrë aktin, ndërhyr duke revokuar atë, pa kaluar afati ankimit në gjykatë për subjektin e cenuar. Ajo gjykatë ka vlerësuar se rregullimi ligjor për përcaktimin e afatit të paraqitjes së padisë ndaj një akti administrativ nuk ka në qëllimin e tij vënien në dispozicion të afatit ndaj organit që ka nxjerrë aktin, sepse ky i fundit është autoriteti që nëse nuk bindet për ligjshmërinë e aktit, nuk ka nevojë ta ndjekë në rrugë gjyqësore, por procedon me revokimin e tij, nëse nuk është shfuqizuar nga organi epror. Në përfundim, për këtë arsyetim, ajo gjykatë ka çmuar se mundësia për të marrë në analizë ligjin material i ishte parashkruar paditësit, pasi nëse ky i fundit do të duhej të analizonte ligjshmërinë e aktit në aspektin e përmbushjes ose jo prej tij të kriterëve ligjore, padia duhej të ishte paraqitur në gjykatë brenda afatit ligjor dhe jo pas 2 vjetësh.

21. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nga ana e tij, me arsyetim të kufizuar, pasi ka renditur shkaqet e rekursit, ka konkluduar në mospranimin e tij, sepse nuk paraqiste asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 dhe se nuk kishte vend për të shqyrtuar ndonjë çështje ligjore që mund të trajtohej kryesisht nga gjykata.

22. Për sa i takon vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Kolegji vëren se ajo gjykatë ka marrë në shqyrtim vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke interpretuar dispozitat e KPA-së së kohës dhe duke dalë në konkluzionin se interpretimi i ligjit nga shkalla e parë nuk ishte i drejtë. Ajo gjykatë, në një interpretim literal dhe logjik të nenit 123 të KPA-së, ka konkluduar se afati i përmendur në pikën 1 të nenit të sipërpërmendur konsiston në faktin që pala e cenuar të mos i drejtohet gjykatës, në eventualitetin që vetë organi që ka nxjerrë aktin, ndërhyr me nismë, duke e revokuar atë, pa kaluar afati i ankimit në gjykatë për këtë palë. Pra, gjykata e apelit ka vlerësuar se afati nuk i kundërdrejtohet organit që e ka nxjerrë aktin, por lidhet me shfuqizimin e tij pa pasur pala e cenuar nevojë t'i drejtohet gjykatës. Në këtë kuadër, Kolegji çmon se, për sa kohë që interpretimi i bërë nga gjykata e apelit nuk është haptazi i

paarsyeshëm, në kuptimin e gabimeve të dukshme që bien ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk duket që ky arsyetim të jetë arbitrar.

23. Duke marrë në analizë vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, Kolegji konstaton se ai është marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit. Vendimi tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tregon se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin që rekursi i paraqitur nga kërkuesi është i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura nuk janë nga ato që parashikon ligji nr. 49/2012. Ky vendim nuk rezulton të jetë kontradiktor në përmbajtjen e tij dhe kërkuesi, edhe pse në mënyrë të kufizuar, ka marrë përgjigje për pretendimet e tij.

24. Si konkluzion, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në tërësinë e tyre, paraqiten të rregullt në formë, të qartë, koherentë dhe pa kundërthënie në përmbajtje, duke respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit i lidhur me të drejtën e aksesit është haptazi i pabazuar.

25. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.